



## PËRMBAJTJA

Fjala e rektorit.....	3	Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare .....	51
Ferizaj.....	4	Pse përzgjedha të studioj në Universitetin e	
Rreth UShAF.....	6	Shkencave të Aplikuara në Ferizaj? .....	52
Historiku .....	6	Mendime të partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë	54
Vizioni, misioni dhe objektivat.....	6	Si të bëhesh student në Universitetin e Shkencave të	
Konferenca e rektorëve .....	9	Aplikuara në Ferizaj .....	56
Struktura organizative .....	11	Periudha e aplikimit.....	56
Autoritetet drejtuese .....	12	Kushtet e aplikimit .....	56
Akreditimi.....	14	Pranimi në UShAF.....	57
Kampusi dhe infrastruktura .....	15	Studime bachelor .....	57
Amfiteatrot.....	16	Studime master .....	57
Ambientet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies ..	17	Transferi .....	58
Laboratorët .....	18	Çështjet financiare.....	58
Biblioteka.....	21	Mësimdhënia dhe mësimnxënia .....	59
Zyra për sigurim të cilësisë .....	22	Nivelet akademike dhe lëndët .....	59
Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar .....	23	Kreditë (ECTS) .....	60
Zyra për orientim në karrierë .....	24	Angazhimi i studentëve .....	61
Zyra për projekte .....	25	Vlerësimi i studentëve .....	61
Numri i studentëve .....	26	Fakulteti i Menaxhmentit .....	62
Fushat e studimit (fakultetet dhe programet).....	27	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia .....	64
Aktivitetet shkencore .....	28	Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit - master ...	66
Instituti .....	30	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës.....	69
Bordi ondustral .....	32	Inxhinieri Industriale me Informatikë .....	70
Alumni .....	34	Informatikë e Aplikuara .....	72
Projektet .....	36	Inxhinieri dhe Menaxhim i Prodhimit – master .....	74
Erasmus+.....	37	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së	
Të tjera .....	38	Drurit .....	76
Paniret e punës brenda UShAF .....	40	Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobileve .....	78
Ekspozitat.....	42	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri .	80
Aktivitetet e lira.....	44	Arkitekturë e Gjellbër dhe Dizajni i Interierit – master .	82
Pse ia vlen të zgjedhni Universitetin e Shkencave të		Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit .....	85
Aplikuara në Ferizaj? .....	46	Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit.....	86
Mësimdhënia .....	48	Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm.....	88
Puna praktike .....	49	Fakulteti i Arteve të Aplikuara .....	90
Ambientet e punës.....	50	Dizajni Grafik dhe Multimedia .....	92
Bashkëpunimi me institucione e biznese kombëtare .	51		

### Përgatitën:

Agron Bajraktari, Etlëvë Blakaj, Blerina Bytyçi

### Dizajni:

Lejla Ibrahim, Florit Hoxha

## FJALA E REKTORIT



Të dashur të rinj të Kosovës dhe më gjerë,

Kam kënaqësinë të ju drejtohem nga një institucion i arsimit të lartë i përkushtuar ndaj ofrimit të një edukimi cilësor dhe të aplikuar. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) synon të harmonizojë kërkesat e tregut të punës me zhvillimet më të fundit teknologjike, duke ndërlidhur njohuritë akademike me përvojën praktike. Andaj edhe misioni ynë është të përgatisim profesionistë të kualifikuar dhe të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës sonë.

Universiteti ynë është gjithmonë i hapur dhe i gatshëm për të mirëpritur gjeneratat e reja të studentëve, të cilët aspirojnë të ndjekin një arsim të avancuar, të bazuar në praktikë profesionale dhe inovacion.

Si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në Kosovë me fokus në shkencat e aplikuara, UShAF ju ofron programe unike të studimit, të cilat janë hartuar duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit teknologjike. Nëpërmjet një metodologjie bashkëkohore të mësimdhënies, e cila ndërthur teorinë me praktikën, studentët tanë fitojnë njohuri të thelluara dhe aftësi të aplikueshme në industri të ndryshme.

Në UShAF, ju do të keni mundësinë të mësoni nga një staf akademik i përgatitur, me përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare, i cili është i angazhuar të ju udhëheqë në rrugëtimin tuaj akademik dhe profesional. Ne investojmë në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke siguruar një ambient modern për studime, laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore dhe mundësi të shumta për zhvillim personal dhe profesional.

Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani kombëtare dhe ndërkombëtare, universiteti ynë ju mundëson të zhvilloni aftësitë tuaja përmes praktikave profesionale, të cilat përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt integritetit tuaj në tregun e punës. Me bashkëpunimin e mirë që kemi me industrinë, ne synojmë të përgatitim profesionistë të aftë dhe inovatorë, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe më gjerë. Një numër i madh i studentëve tanë tashmë janë pjesë e bizneseve dhe institucioneve të ndryshme vendore dhe të huaja, ku kanë pasur mundësinë të dëshmojnë aftësitë e tyre dhe të ndërtojnë karrierën e tyre me sukses.

Gjithashtu, UShAF ka krijuar partneritete me universitete prestigjioze në Evropë dhe më gjerë, duke ju ofruar studentëve mundësi të shkëlqyera për mobilitete studentore dhe shkëmbime akademike. Kjo ju mundëson të përfitoni nga përvojat ndërkombëtare, të njiheni me praktikatat më të mira të industrisë dhe të zgjeroni horizontin tuaj akademik.

Përveç mësimdhënies dhe praktikës profesionale, universiteti ynë është i pasur me aktivitete shkencore, kulturore dhe vullnetare, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e gjithanshëm të studentëve. Përmes këtyre aktiviteteve, ju do të keni mundësinë të zhvilloni aftësitë tuaja sociale, të krijoni lidhje profesionale dhe të përgatiteni për sfidat e së ardhmes.

Diploma e fituar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është një mundësi e mirë për një të ardhme të suksesshme, duke ju ofruar mundësi të shumta punësimi dhe avancimi në karrierë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në tregun evropian dhe më gjerë. Edhe pse një universitet i ri, ne kemi dëshmuar tashmë se jemi një institucion dinamik dhe inovativ, i cili përgatit studentët për sfidat e një bote gjithnjë në ndryshim. Ju ftoj që të bëheni pjesë e familjes sonë akademike dhe të përfitoni nga të gjitha mundësitë që UShAF ofron. Jemi këtu për të mbështetur rrugëtimin tuaj drejt suksesit dhe për të ju ndihmuar të arrini potencialin tuaj të plotë.

Mirë se vini në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj!

Prof. Dr. Dr. Dr. DI. PDoc. Agron Bajraktari, MSc., MBA  
Rektor | Rector

## FERIZAJ

Qyteti i Ferizajt është i vendosur në jug të Kosovës, dhe ndodhet vetëm 37 km larg kryeqytetit të vendit, Prishtinës. Kosova, një vend i shtrirë në qendër të Ballkanit, me një sipërfaqe prej 10.887 km<sup>2</sup> dhe popullsi 1.8 milion banorë, u shpall Republikë me 17 shkurt 2008.

Republika e Kosovës ka një territor me bukuri të shumëllojshme natyrore, të cilat ofrojnë një mundësi të mirë të zhvillimit të turizmit. Ferizaj, ku ndodhet Universiteti i Shkencave të Aplikuara, me një popullsi prej rreth 108,690 banorë dhe me një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup>, ka filluar të zhvillohet që nga viti 1873 me ndërtimin e hekurudhës dhe të stacionit hekurudhor.

Ferizaj ka qenë edhe qytet i ngjarjeve të mëdha historike, ndër të cilat veçohet Kuvendi i madh i shqiptarëve, korrik 1908, që pati ndikim shumë të madh në zhvillimet shoqërore në perandorinë osmane.

Sot, krahasuar me qytetet tjera konsiderohet të jetë qyteti i dytë më i zhvilluar pas Prishtinës. Thuhet të jetë qytet i tregut në Kosovë në saje të

numrit të madh të fabrikave, ndërmarrjeve dhe bizneseve të koncentruara në këtë rajon.

Shquhet poashtu edhe për turizmin. Pos tjerash le ta përmendim fenomenin e veçantë natyror Bifurkacionin e lumit Nerodimja, gjysma e të cilit, përmes të Moravës derdhet në Detin e Zi, e gjysma tjetër, përmes të Vardarit, derdhet në Detin Egje.



# RRETH UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

## HISTORIKU

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) është themeluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), më 6 korrik 2015 dhe është ratifikuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës më 16 korrik 2015.

Tradita e punës akademike dhe shkencore në Ferizaj daton nga viti 1976, kur Kuvendi i Kosovës themeloi Qendrën e Shkollimit të Lartë. Në Qendër funksiononte Seksioni i Makinerisë dhe Industrisë së Drurit, si dhe Seksioni i Punëtorëve.

Në vitin akademik 1988, Qendra e Shkollimit të Lartë suprimohet dhe themelohet Shkolla e Lartë Teknike, me Seksionin e Makinerisë dhe të Industrisë së Drurit, ndërsa Seksioni i Punëtorëve u suprimua tërësisht.

Në vitin akademik 2002/03 u miratuan plan-programet e reja mësimore sipas sistemit të Bolonjës për studime themelore (Bachelor), për Departamentin e Makinerisë me profilin: Teknika e Përpunimit të Materialeve Artificiale dhe Departamentin e Industrisë së Drurit me profilin: Përpunimi i Drurit.

Me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, më 05.09.2005, Shkolla e Lartë Teknike transformohet në Fakultet të Shkencave Teknike të Aplikuara (FSHTA), me Departamente dhe profile të njëjta, ndërsa më vonë në Fakultet të Shkencave të Aplikuara (FSHA), duke i mundësuar Fakultetit të zhvillojë programe përtej atyre teknike.

## VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT

### Vizioni

Vizioni ynë është të bëhemi model kombëtar i një universiteti modern, inovativ dhe i edukimit integruar, ku praktika plotëson teorinë dhe ku zhvillohen aftësi profesionale për të mirën e shoqërisë.

### Misioni

Jemi të përkushtuar të ofrojmë arsim cilësor, që të përgatisim profesionistë të kualifikuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.

## Objektivat e përgjithshme

Që të arrijë Vizionin dhe Misionin e tij, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj:

- Ofron arsim cilësor të harmonizuar me kërkesat e industrisë, duke implementuar arsimim që është i orientuar kah punësueshmëria, po edhe i balancuar midis teorisë dhe praktikës, për të pajisur, kështu, studentët me njohuritë dhe shkathtësitë e kërkuara, për të përparuar në treg të punës dhe për të kontribuar mirëfilli në shoqëri.
- Nxitë hulumtimin dhe zhvillimin e shkathtësive profesionale, duke kultivuar një ambient ku studentët dhe mesimdhënësit angazhohen në hulumtim inovativ dhe zhvillim të shkathtësive, për të përgatitur të diplomuar të përkushtuar në hulumtim dhe profesionistë, të cilët udhëheqin në fushat përkatëse.
- Promovon ndërgjegjen etike dhe përgjegjësinë, duke përçarur një ndjenjë të fortë etike, respekti, ndershmërie dhe integriteti brenda komunitetit të universitetit, për të nxitur tek studentët një sjellje të përgjegjshme dhe të kompletuar, që kontribuon pozitivisht në shoqëri.
- Inkurajon të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të menduarit kritik aktiv, duke frymëzuar studentët të mirëpresin të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe duke promovuar angazhimin aktiv dhe të menduarit kritik, për t'i përgatitur ata të përshtaten dhe të kenë sukses në një shoqëri dhe industri gjithnjë e në zhvillim.
- Forcon partneritetin dhe bashkëpunimin, duke ndërtuar dhe mirëmbajtur bashkëpunimin me studentë, me të diplomuar, me industri, me institucione qeveritare, me akterë të komunitetit kombëtar e ndërkombëtar, për të mbështetur rritjen dhe avancimin e ndërsjellë.
- Synon përsosmëri dhe inovacion, duke u përkushtuar në mesimdhënie të përsosur, në kreativitet shkencor dhe në inovacion, duke përmirësuar vazhdimisht standardet akademike, duke promovuar kërkimin shkencor, si dhe duke zhvilluar qasje të reja në arsim.
- Mirëpret diversitetin dhe gjithëpërfshirjen, duke krijuar një ambient gjithëpërfshirës që vlerëson ide të ndryshme, besime, kultura dhe etnicitete, si dhe duke promovuar një kampus ku gjithësecili ndihet i respektuar dhe i lirë të ndajë përvojat unike.

Pra, qëllimi ynë është të ju përkrahim dhe udhëzojmë të zhvilloni personalitetin tuaj kreativ që të përmbushni sa më mirë potencialin tuaj individual.

Kjo realizohet duke ju ofruar programe që nuk ju kufizojnë në aspektin kreativ, që janë të orientuara kryesisht kah praktika, që ofrojnë përkrahje individuale dhe mundësi ndërkombëtare. E gjithë kjo falë edhe bashkëpunimit me shumë institucione kombëtare e ndërkombëtare.

## KONFERENCA E REKTORËVE

Me datë 16 qershor 2016 u themelua Konferenca e Rektorëve, pjesë e së cilës, normalisht, është edhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Konferenca e Rektorëve merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rolin dhe detyrat e institucioneve të arsimit të lartë në komunitetin akademik dhe në shoqëri në përgjithësi, posaçërisht me mësimdhënie dhe mësimnxënie, kërkim shkencor, inovacion, trajnime të mëtejme shkencore, ndërkombëtarizim si dhe me vetadministrim dhe qeverisje të universiteteve.





## STRUKTURA ORGANIZATIVE

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) operon me një strukturë organizative të ndërtuar me kujdes për të siguruar një funksionim efikas dhe të balancuar midis autoriteteve drejtuese, njësive akademike dhe atyre administrative. Kjo strukturë mbështetë misionin e universitetit në ofrimin e arsimit të lartë cilësor, të orientuar drejt praktikës dhe inovacionit.



## AUTORITETET DREJTUESE

Struktura organizative e UShAF bazohet në autoritete qeverisëse, të cilat përcaktojnë politikat dhe strategjitë e zhvillimit të institucionit.

- **Këshilli Drejtues** është organi më i lartë vendimmarrës, përgjegjës për miratimin e politikave strategjike, planifikimin afatgjatë dhe menaxhimin e buxhetit të universitetit. Ky Këshill, varësisht nga kërkesat e universitetit, merr vendime që çojnë përpara institucionin.
- **Rektori** është figura ekzekutive kryesore, përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të institucionit. Ai udhëheq universitetin me vizion dhe siguron që të gjitha proceset akademike dhe administrative të funksionojnë në harmoni me objektivat institucionale.
- **Senati** është organi më i lartë akademik, i cili, në fokus, ka zhvillimin e programeve të studimit, e kërkimeve shkencore dhe e standardeve akademike. Vendimet e Senatit ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit dhe orientimin strategjik të fakulteteve.
- **Këshilli Mësimor/Shkencor** mbështet procesin akademik dhe kërkimor të universitetit duke marrë vendime mbi organizimin e mësimin, zhvillimin e kurrikulave dhe promovimin e aktiviteteve shkencore dhe krijuese.

## PROREKTORËT

Për të siguruar një menaxhim efikas dhe të specializuar të universitetit, Rektori mbështetet nga pesë prorektorë, secili prej të cilëve mbulon një fushë specifike të zhvillimit institucional:

- Prorektori për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore;
- Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë;

- Prorektori për Bashkëpunim me Industrinë, Punë Praktike dhe Aktivitete Komerciale;
- Prorektori për Inovacion, Teknologji dhe Digjitalizim;
- Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.

## NJËSITË AKADEMIKE - FAKULTETET

Universiteti ka pesë fakultete, të cilat ofrojnë programe studimore të specializuara, zhvillojnë kërkime shkencore dhe nxisin aktivitete krijuese. Secili fakultet udhëhiqet nga dekani përkatës, i cili është përgjegjës për menaxhim akademik dhe administrativ të njësisë përkatëse, duke siguruar funksionim efikas dhe përmbushje të objektivave institucionale.

- Fakulteti i Menaxhmentit
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
- Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
- Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
- Fakulteti i Arteve të Aplikuara

## NJËSITË ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE

Përveç njësisë akademike, universiteti funksionon përmes një strukture të mirëorganizuar administrative, e cila siguron menaxhimin e përditshëm të operacioneve të institucionit.

- Administrata Qëndrore, është struktura që mbështet të gjitha njësitë akademike dhe ofron shërbime për studentët dhe stafin akademik.
- Sekretari i Përgjithshëm, është përgjegjës për administrim të përgjithshëm të Universitetit.
- Zyrat Administrative, janë njësi të ndryshme që mbulojnë çështje të burimeve njerëzore, financave, shërbimeve studentore dhe teknologjisë së informacionit.





## AKREDITIMI

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është institucion i arsimit të lartë i akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).

Përmes procedurave të ndryshme që përfshihen si gjatë akreditimit institucional ashtu edhe gjatë akreditimit të programeve studimore, të kërkuara nga AKA, Universiteti ynë kujdeset të përmbushë kushtet e duhura të cilësisë, si: transparencë, krahasueshmëri, përmes së cilës ofron mundësi më të mira zgjedhjeje në tregun e punës kombëtar e ndërkombëtar, lehtësim mobiliteti ndërkombëtar, etj.

## KAMPUSI DHE INFRASTRUKTURA

Kampusi i Universitetit të Shkencave të Aplikuara, i shtrirë në jug-lindje të Ferizajt posedon një hapësirë mbi 7000 m<sup>2</sup>.

## AMFITEATROT

Brenda hapësirave të Universitetit është një amfiteatër i madh me 400 ulëse dhe një tjetër, më i vogël, me 150 ulëse.



## AMBIENTET E MËSIMDHËNIES DHE TË MËSIMNXËNIES

Universiteti, pos amfiteatrove, posedon edhe 15 ambiente të tjera, të madhësive të ndryshme. Të gjitha ambientet e kanë pajisjen adekuate dhe moderne për mësimdhënie dhe mësimnxënie, ndërsa disa prej tyre, janë të pajisura edhe me Smart projektorë.



## LABORATORËT

Laboratorët, në kuadër të fakulteteve, janë të pajisur me teknologjinë më të sofistikuar, që jo vetëm mundësojnë realizimin e punës praktike, por edhe përvetësimin sa më të mirë të programeve studimore.

Laboratori i Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit është i pajisur me **makineri tradicionale dhe me ato më moderne, të njohura si "CNC" ("Computer Numerical Control")**. Këto pajisje përdoren nga studentët për prodhimin e produkteve të interierit.

Në kuadër të laboratorit është edhe klasa e quajtur **"inLAB"**, e cila është e pajisur me **printerë dhe skanerë modern 3D**, të mbështetur me **pajisjet e realitetit virtual**, të njohura si **"VR HeadSet"**.

Në një klasë tjetër ofrohen **pajisje për matjen e lagështisë së drurit, peshës specifike, tharësen eksperimentale të drurit, pajisje për vrojtimin e qelizave të drurit**, si dhe të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për prodhimin e produkteve të interierit.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës ka katër laboratorë:

- laboratorin CAD/CAM/CNC,
- laboratorin e teknikës së përpunimit të metaleve,
- laboratorin e teknikës së saldimit, dhe
- laboratorin e energjisë së ripërtëritshme.

Laboratorët janë të pajisur me makineri tradicionale dhe moderne, të njohura si "CNC", të cilat shërbejnë për prodhimin e produkteve nga metali. **Laboratori i energjisë së ripërtëritshme** është i pajisur me sisteme që mundësojnë shfrytëzimin e energjisë diellore me qëllim të përfitimit të energjisë termike për ftohje/ngrohje, si dhe sisteme fotovoltaike për përfitimin e energjisë së dritës.

Ky fakultet ka edhe **laboratorin e fizikës dhe kimisë** me një numër të mjaftueshëm të mjeteve konkretizuese/aparaturave laboratorike si dhe **dy kabinete të informatikës**.

Universiteti shumë shpejt do ta ketë laboratorin për prova të materialeve (metaleve dhe jometaleve) si dhe laboratorin e teknologjisë së përpunimit të materialeve polimere - TPMP - Plastmasave.





## BIBLIOTEKA

Biblioteka e Unversitetit ka një numër të konsiderushëm të titujve nga fushat e programeve studimore, të cilat janë në shërbim të studentëve dhe të mësimdhënësve.

Që studentët, po edhe stafi akademik, të kenë mundësi më të mira kërkimore shkencore, të mësimdhënies e mësimnxënies, UShAF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, e cila ofron qasje jo vetëm në librat fizik, po edhe në ato digjitale.

UShAF, duke qenë poashtu anëtar i Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, ofron qasje në shumë burime elektronike (revista e libra shkencorë) të njohura ndërkombëtarisht.

## ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

Zyra për sigurim të cilësisë luan rol kryesor në zhvillimin, monitorimin dhe raportimin e cilësisë në mbarë Universitetin. Kjo zyrë ka një mision si dhe objektiva të përcaktuara qartë, të cilat tregojnë përkushtimin e Universitetit për përmirësim të vazhdueshëm të veprimtarisë së vet.

Sigurimi i cilësisë së lartë në mësimdhënie, mësimnxënie, në kurrikula, hulumtim dhe administrim, përmes zhvillimit, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve dhe procedurave për sigurim të cilësisë, i kanë shërbyer vizionit të UShAF-it të bëhet model kombëtar i një universiteti modern, inovativ, kërkimor dhe i edukimit integruar. Kjo ka mundësuar që të diplomuarit tanë të përvetësojnë shkathtësi shumë të mira, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit lokal e global.

Parimet mbi të cilat ndërtohet Universiteti ynë janë zhvillimore, me qëllim që të sigurohet përmirësim i vazhdueshëm përmes përfshirjes së të gjitha palëve përkatëse brenda dhe jashtë Universitetit. Zyra për sigurim të cilësisë mbështetet në disa parime:

- Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi janë pjesë e strategjisë së Universitetit për të siguruar mësimdhënie, mësimnxënie, kurrikula e aktivitete shkencore cilësore.
- Sigurimi i cilësisë si dhe praktikrat e përmirësimit dokumentohen, monitorohen, rishikohen dhe vlerësohen.
- Sigurimi i cilësisë është hartuar me qëllim të përmbushjes së kërkesave të aprovimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe procesit të akreditimit.
- Sigurimi i cilësisë fokusohet në kontributin, proceset, rezultatet dhe në ndikimin e përgjithshëm.



## ZYRA PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Në një treg global të punës, përvetësimi i gjuhëve të huaja si dhe i kompetencave ndërkulturore është qenësor. Prandaj, ndërkombëtarizimi është temë kyçe e Universitetit tonë. Që kjo të realizohet Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar së bashku me Rektoratin dhe me përfaqësuesit e programeve studimore, koncepton dhe zbaton aktivitete dhe politika të ndërkombëtarizimit. Këtë më së miri e realizon përmes zhvillimit, po edhe ruajtjes së bashkëpunimit me institucione e agjensione të ndryshme ndërkombëtare të arsimit të lartë, me fokus në shkencat të aplikuara.

UShAF ka një partneritet jashtëzakonisht aktiv me Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Salzburg, bashkëpunim ky i cili filloi në vitin 2006.

Pos me Salzburg-un, universitet në Austri, UShAF bashkëpunon edhe me shumë institucione tjera të arsimit të lartë në Britaninë e Madhe, në Gjermani, në Irlandë, në Turqi, në Poloni e në shumë vende të tjera të botës.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është punuar edhe akoma punohet në ngritjen e kapaciteteve sa i përket sigurimit të cilësisë, hartimit apo adaptimit të kurrikulave ekzistuese, ngritjes profesionale si dhe është mundësuar e mundësohet akoma mobilitet i stafit akademik dhe i studentëve. Në kuadër të mobilitetit UShAF ka pritur edhe shumë ligjërues mysafirë, të cilët kanë ofruar përvojat e tyre.



## ZYRA PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Zyra për orientim në karrierë ndihmon studentët, po edhe të diplomuarit, në shtegtimin e tyre nga të qenët student deri në momentin e hyrjes në treg të punës, e madje edhe më tej. Përfaqësuesit e kësaj zyreje, në bashkëpunim me instancat tjera në kuadër të Universitetit,

përkrahin studentët në zgjerimin e perspektivave të tyre, në vënien në pah të potencialit të tyre profesional e personal, në përdorimin e rrjeteve si dhe në zhvillimin e aftësive metodologjike dhe organizative, të cilat i përgatitin ata për botën profesionale të punës.



## ZYRA PËR PROJEKTE

Zyra për projekte, si pjesë e UShAF-it, ka për synim hulumtimin e tregut kombëtar e ndërkombëtar me qëllim të identifikimit të mundësive sa i përket hartimit të projekteve si dhe bashkëpunimit me institucione përkatëse.

Pas hulumtimit të tregut dhe identifikimit të mangësive, përfaqësuesit e kësaj zyreje, në bashkëpunim me insitucionet përkatëse hartojnë projekte, të cilat financohen nga donatorë kombëtarë e ndërkombëtarë.

## NUMRI I STUDENTËVE

Çdo vit UShAF pranon 60 studentë të rregullt në programin Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë, 80 studentë në programin Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, në programet e studimit Inxhinieri Industriale me Informatikë dhe në Informatikë të Aplikuar nga 60 studentë, 60 studentë në programin Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve, 40 studentë në programin Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, dhe 40 studentë në programin Dizajn Grafik dhe Multimedia. Të gjitha këto në nivelin Bachelor, ndërsa nga 30 studentë për secilën

fushë studimi në nivelin Master, me përjashtim në programin e studimeve Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit ku pranohen 50 studentë.

Numri i studentëve që pranohen çdo vit mund të ndryshojë varësisht nga kushtet që parashtrihen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Në kuadër të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është **Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së**

## FUSHAT E STUDIMIT (FAKULTETET DHE PROGRAMET)

**Drurit**, me programe në studimet Bachelor në Arkitekturë të Interierit dhe Dizajn të Mobilieve, si dhe Dizajn dhe Konstruksione të Produkteve nga Druri, ndërsa në studimet Master ofron programin në Arkitekturë e Gjelbër dhe Dizajni i Interierit, pastaj është Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës me program në studime Bachelor në Inxhinieri Industriale me Informatikë, dhe në Informatikë të Aplikuar, ndërsa me program në studime Master në Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit.

Universiteti ka edhe Fakultetin e Turizmit dhe Ambientit, me program në studime Bachelor në Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë dhe me program në studimet Master në Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm, pastaj Fakultetin e Menaxhmentit me program në studimet Bachelor në Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia dhe programin Master në Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit si dhe Fakultetin e Arteve të Aplikuara me program në studimet Bachelor në Dizajn Grafik dhe Multimedia.



## AKTIVITETET SHKENCORE

Aktiviteti shkencor është një shtyllë jashtëzakonisht e rëndësishme e veprimtarive të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Kërkimi shkencor i Universitetit karakterizohet me zbatueshmërinë e botës reale, si dhe me lidhjen e ngushtë me biznesin, industrinë dhe shoqërinë në përgjithësi. Shkathtësitë kërkimore të hulumtuesve tanë janë dëshmuar përmes një numri të madh të publikimeve në revista të njohura shkencore, po edhe të pjesëmarrjes në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.

Që aktiviteti shkencor të zhvillohet edhe më tej, Rektorati, çdo vit, ofron për çdo mesimdhënës të rregullt një shumë të caktuar të hollash, me të cilat stafit akademik i mundësohet pjesëmarrja në konferenca të ndryshme, po edhe publikimi në revista me impakt faktor.

Universiteti poashtu përdor teknologji dhe laboratorë modern, duke krijuar kështu një infrastrukturë efikase për kërkime shkencore. Aktivitetin shkencor, Universiteti, normalisht e përqëndron në fusha të ndryshme, po që janë të rëndësishme dhe në përputhje me programet e studimit. Kjo i mundëson Universitetit të koncentrohet në cilësitë që e shquajnë dhe në këtë mënyrë të konkurojë me efikasitet në nivel kombëtar e ndërkombëtar.



## INSTITUTI

Insituti ndërdisiplinar i Universitetit është një partner i fortë i industrisë dhe biznesit sa i përket zhvillimit dhe kërkimit shkencor të aplikuar. Në bashkëpunim me industrinë dhe biznesin, përmes projekteve të ndryshme zhvillohen produkte inovative dhe që përshtaten me tregun e punës. Nga ky bashkëpunim përfitojnë jashtëzakonisht shumë studentët, të cilët janë direkt të përfshirë në projektet që zbatohen e realizohen në kuadër të institutit.



## BORDI INDUSTRIAL

Në vitin 2016 Universiteti themeloi Bordin Industrial, pjesë e të cilit tashmë janë me qindra kompani me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto marrëveshje nuk

lehtësojnë vetëm realizimin e punës praktike të studentëve, po, përmes takimeve të shpeshta të përfaqësuesve të kompanive me përfaqësues të Universitetit, kontribuohet bashkarisht në

adaptimin e programeve studimore bazuar në kërkesat e tregut të punës, e me këtë mundësohet edhe balancimi midis kërkesës dhe ofertës së tregut.

Në këtë mënyrë ofrohen programe të orientuara kah industria, të cilat krijojnë kushte ideale për të filluar një karrierë me shumë ndikim në botën e biznesit.





## ALUMNI

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në vitin 2019, ka themeluar Asociacionin Alumni, për të bashkuar të diplomuarit e këtij Universiteti me vet institucionin, me qëllim:

- të shkëmbimit të përvojave me njëri-tjetrin;
- të përdorimit të përvojave të pasura të të diplomuarve të këtij institucioni, për përfitimin dhe përparimin e studentëve aktual;
- të sigurimit të udhëzimeve adekuate për studentët aktual në përpjekjet e tyre për punësim më të mirë, apo për studime të mëtejme;
- të promovimit të Universitetit përmes të të diplomuarve që punojnë në industri me renome kombëtare e ndërkombëtare; dhe
- të përvetësimit të këshillave frytdhënëse të Alumnit në zhvillimin e përgjithshëm të Universitetit.



## PROJEKTET

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është pjesë e një numri të konsiderueshëm të projekteve ndërkombëtare, si Erasmus+ poashtu edhe e projekteve të tjera të financuara nga qeveria austriake dhe gjermane.

Në kuadër të këtyre projekteve është punuar për ngritjen e kapaciteteve, sa i përket hartimit të kurrikulave, sigurimit të cilësisë, ngritjes profesionale si dhe zhvillimit të karrierës së studentëve. Përmes këtyre projekteve, ndër vite, është krijuar një bashkëpunim jashtëzakonisht i mirë me institucione të ndryshme në mbarë botën.

## ERASMUS+

Universiteti ynë është pjesë e shumë projekteve në kuadër të programit Erasmus+. Duke qenë pjesë e këtyre projekteve UShAF ka krijuar një rrjet bashkëpunimi me shumë institucione e agjensione nga vende të ndryshme të botës, si nga Britania e Madhe, Austria, Gjermania, Polonia, Irlanda, Turqia, etj. Në kuadër të bashkëpunimeve të shumta, të fokusuara kryesisht në fushën e shkencave aplikative, është punuar në ngritjen e kapaciteteve, sa i përket hartimit të kurrikulave në harmoni me kërkesat e tregut të punës, e kapaciteteve menaxheriale, administrative, të inovacionit, ndërkombëtarizimit, sigurimit të cilësisë, po është mundësuar edhe mobilitet i stafit akademik, administrativ e sidomos i studentëve. Përmes projekteve të Erasmus+, poashtu është synuar krijimi dhe forcimi i bashkëpunimit midis universiteteve dhe ndërmarrjeve, me qëllim të përgatitjes sa më profesionale të studentëve.



## TË TJERA

UShAF, ndër vite, është përfshirë edhe në projekte të donatorëve të ndryshëm ndërkombëtarë. Këtu vlen të përmendet përkrahja e qeverisë austriake, e cila për shumë vite me Projektet KAIP, HIGHERKOS e HERAS i ka ofruar Unversitetit tonë bashkëpunim me institucione e agjensione të ndryshme të arsimit të lartë në Austri, e sidomos me Unversitetin e Shkencave të Aplikuara në Salzburg, Austri.

Partneriteti me Salzburg-un që nga viti 2006 ka mundësuar rishikimin dhe adaptimin e kurrikulave ekzistuese, zhvillimin e programeve të reja studimore, bazuar në kërkesat e tregut të punës, po edhe në përvojën shumëvjeçare të Universitetit të Salzburg-ut, pastaj zhvillimin e njohurive dhe kapaciteteve në hulumtime shkencore dhe menaxhment, hartimin dhe publikimin e kërkimeve

të përbashkëta shkencore, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit afatgjatë midis UShAF, industrisë dhe akterëve lokal.

Gjithashtu, me përkrahje të GIZ-it, UShAF ka organizuar dy panaire të punës ku bizneset kanë ofruar rreth 250 vende të lira pune vetëm për studentë të universitetit tonë.

Në tetor të vitit 2018, Universiteti ynë u bë pjesë e Asociacionit Evropian të Institucioneve të Arsimit të Lartë (EURASHE), i cili është përfaqësuesi kryesor i arsimit të lartë profesional në Evropë.



## PANAIRET E PUNËS BRENDA USHAF

Çdo vit Universiteti, brenda hapësirave të tij, organizon panairin e punës, ku nga kompanitë e ndryshme, të cilat marrin pjesë në panair e me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi, ofrohen mundësi të shumta punësimi për studentët.

Kjo për arsyen se veprimtaria e të gjitha kompanive pjesëmarrëse përputhet pothuajse tërësisht me programet e studimit që ofrohen në Universitetin tonë. Studentëve të këtij institucioni, nga kompanitë e ndryshme çdo vit u ofrohen afro 250 vende të lira pune.

## EKSPOZITAT

Që nga themelimi i tij, Universiteti çdo vit organizon ekspozitën "Profesionistët e së ardhmes", ku studentëve të të gjitha programeve studimore, përmes punimeve të ndryshme, u jipet mundësia të shprehin idetë e tyre kreative e inovative. Punimet e realizuara janë nga më të ndryshmet, nga maketat, vizatimet e projektimet e përgatitura deri në detaje, deri te përgatitja e ushqimit dhe shërbimi.

Të gjitha këto shkathtësi të përvetësuar në kuadër të fushave të studimit, që ofrohen në Universitet, studentët i paraqesin para një publiku të larmishëm, pjesë e së cilës janë edhe bizneset, të cilave duke qenë çdo vit pjesë e këtij panairi, u mundësohet ta përcjellin hap pas hapi ngritjen profesionale të studentëve.



## AKTIVITETET E LIRA

Universiteti ynë organizon, po edhe merr pjesë në shumë aktivitete ekstrakurrikulare. Nga viti 2016 studentët e Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit marrin pjesë në “Garën studentore për dizajn”, e cila organizohet nga “Shoqata e Kosovës e përpunuesve të drurit”.

Falë angazhimit të studentëve dhe të përkrahjes së palodhshme të stafit akademik, numri i studentëve tanë pjesëmarrës në këtë garë është shumë më i madh në krahasim me universitetet dhe kolegjet tjera pjesëmarrëse. Puna e jashtëzakonshme e Universitetit tonë, qysh në vitin e parë të pjesëmarrjes, është kurorëzuar me marrjen e çmimit të parë, nga një student yni (Drilon Rexhepi), pastaj në vitin e dytë UShAF është marrë si shembull i suksesit për hartimin e programeve, krijimin e bordit industrial, punën praktike në ndërmarrje, si dhe numrin e studentëve të punësuar pas përfundimit të studimeve.

Studentët, në bashkëpunim me stafin akademik, çdo vit marrin pjesë me punimet e tyre në aktivitete vullnetare. Fitimet e marra nga punimet e shitura shkojnë si donacion tek fëmijët në nevojë.

Studentët poashtu angazhohen vullnetarisht në dizajnimin e hapësirave të brendshme të Universitetit, duke shprehur kështu idetë e tyre kreative përmes një pune të realizuar jashtëzakonisht mirë. I tillë është rasti me këndin për lexim dhe aktivitete të tjera të lira, i financuar nga Projekti HERAS dhe UShAF.

Çdo vit Universiteti organizon udhëtim në Strazhë ku organizohen shumë aktivitete të lira. Ky lloj organizimi mundëson krijimin e raporteve më të mira midis stafit akademik e administrativ dhe studentëve.



**4** GARA  
EDICIONI STUDENTORE  
PËR DIZAJN

“  
FAKTI QË KAM FITUAR  
VENDIN E PARË MË KA  
NDIHMUAR SHUMË NË  
KARIEREN TIME  
PROFESIONALE.  
”

**DRILON REXHEPI**  
NJË NGA FITUESIT E EDICIONIT TË PARË

A photograph of a man wearing headphones, likely Drilon Rexhepi, in a workshop setting. He is looking towards the camera. The background shows a workshop with a sign that says "3D ROLLER".

## PSE IA VLEN TË ZGJEDHNI UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ?

Nëse jeni më shumë të interesuar për zhvillimin e përvojës praktike, e jo vetëm në teori, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është vendi i duhur për ju. Programet e studimit në universitete të tilla, ndryshe nga universitetet tjera, janë të orientuara jashtëzakonisht shumë në praktikë.

Po pse ndodh kjo? Shkenca e aplikuar është një disiplinë që përdoret për të aplikuar njohuritë shkencore të fituara, me qëllim të përparimit të teknologjisë. Pas tjerash përdoret edhe në mjedise industriale, si mjet për kërkime, për shpikje dhe zhvillim.

Që të jeni të përgatitur për jetën tuaj profesionale, e jo vetëm të mësoni teori të ndryshme, UShAF ofron programe studimi të orientuara kah tregu i punës.

Punëdhënësit kërkojnë përvojë pune që ju kualifikon për një pozitë. Programet e studimit

në Universitetin e Shkencave të Aplikuara janë të hartuara që të ju përgatitin profesionalisht. Praktika profesionale, e kërkuar dhe e integruar në programet studimore, ju mundëson të përfitoni përvojë të vlefshme krahas studimeve.



## MËSIMDHËNIA

Me programe studimore të orientuara kah praktika, Universiteti ynë ofron mjedise ku mësimdhënia teorike është e ndërlidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien praktike. Mësimdhënësit funksionojnë si planifikues, aftësues, motivues e këshilltar profesional.

Që të ketë mësimdhënie adekuate, gjatë procesit mësimor, mësimdhënësit bashkëpunojnë me studentët, përfaqësues të komunitetit të biznesit, si dhe akterë të tjerë të rëndësishëm.

Me mësimdhënien që ofrohet në institucionin tonë studentët përgatiten të vlerësojnë rëndësinë

e përvojave arsimore në klasë dhe në terren, si dhe të kuptojnë se derisa përvoja është një mësues i shkëlqyeshëm, ajo nuk mund të zëvendësojë atë që mund të mësohet më mirë në një klasë dhe anasjelltas.

Stafi mësimor i kualifikuar dhe me përvojë, si në fushat shkencore ashtu edhe ato praktike, garanton një arsim akademik më standarde të larta, të përqendruar në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve, mbështetur nga një gamë e gjerë e të mësuarit dhe të metodave të vlerësimit.




## PUNA PRAKTIKE

Qëllimi i realizimit të punës praktike të studentëve është ndërlidhja e aftësive teorike me aplikim praktik në vend real të punës, përmes së cilës studentët aftësohen më mirë në profesionin e përzgjedhur.

Puna praktike e studentëve realizohet në institutet e Universitetit për programet përkatëse, ndërsa një pjesë e madhe e saj realizohet në ndërmarrjet me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi.

Studenti, në punën praktike, paraprakisht i ka të përcaktuara objektivat e punës, të cilat ndërlidhen me programin e studimeve dhe njëkohësisht reflektojnë në mënyrë aktive në atë çka është duke mësuar. Në vartësi të fushës së studimit përcaktohet edhe lloji i praktikës, mbështetur në programin e studimeve.





## AMBIENTET E PUNËS

Universiteti ofron ambiente të përshtatshme e moderne të punës, si për studentë, poashtu edhe për stafin akademik dhe atë administrativ.

Instituti i Shkencave të Aplikuara, në kuadër të Universitetit, ofron punëtori e laboratore të ndryshme dhe moderne, ku studentët, nën mbikëqyrjen e mësimitdhënësve, realizojnë një pjesë të punës praktike.

Në kuadër të Institutit është edhe qendra e inovacioneve, me pajisjet më moderne, si 3D printerë dhe 3D skanerë, me VR Headsets, CNC makina, Printer/ Ploter, e pajisje të tjera, të cilat shërbejnë për krijimin dhe dizajnimin e produkteve të ndryshme.



## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E BIZNESE KOMBËTARE

Bashkëpunimi midis Universitetit, komunitetit të biznesit, po edhe institucioneve tjera të rëndësishme, i ndihmon të diplomuarit të fitojnë aftësi adekuate për tregun e punës dhe për zhvillimin e tyre personal.

Krijimi i një bashkëpunimi të ngushtë midis institucionit tonë dhe bizneseve ka inkurajuar shkëmbim të njohurive, krijim të mundësive afatgjata, si dhe nxitje të inovacionit, ndërmarrësisë dhe kreativitetit. Të gjitha këto kanë mundësuar themelimin e Bordit Industrial, i cili funksionon në kuadër të Universitetit dhe pjesë e të cilit janë përfaqësues nga industria, si dhe nga Universiteti.



## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

Ndërkombëtarizimi i sistemit të arsimit dhe sigurimi i cilësisë janë çështje në të cilat Universiteti punon pandërprerë. Këto arrihen përmes të mësuarit reciprok, bashkëpunimit të ndërsjellë dhe krahasimit midis sistemeve të arsimit në mbarë botën.

Bashkëpunimi me institucione të ndryshme ndërkombëtare nxit inovacion dhe krijim të vendeve të punës përmes mobilitetit dhe ofron mundësi për stafin akademik e administrativ, si

dhe për studentët, të zgjerojnë horizontin e tyre. Këto ofrohen përmes bashkëpunimit që Universiteti ynë ka me institucione të ndryshme ndërkombëtare të arsimit të lartë, i cili mundësohet në kuadër të programit Erasmus+, apo edhe përmes projekteve të ndryshme të implementuara në Kosovë, nga vende të ndryshme si Britania e Madhe, Austria, Gjermania, Irlanda, Polonia, Turqia, etj.



## PSE PËRZGJODHA TË STUDIOJ NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ?



**Anduela Kasumaj,**  
e diplomuar në programin e studimeve  
Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve:

*“Përgjatë studimeve patëm mundësi të jashtëzakonshme që me talentin, punën dhe përkushtimin tonë të fitojmë eksperiencë dhe të jemi të gatshëm për tregun e punës. Organizimet e ndryshme, në kuadër të Universitetit, si: ekspozita e përojetshme “Profesionistët e së ardhmes”, ekspozitat e fundvitit, panairët e punës, praktikant në kompani, vizitat e ndryshme me interes të lartë për studentët, pjesëmarrja në Gara të Dizajnit, mundësia e përfitimit të granteve të ndryshme nga organizata ndërkombëtare (siç pata fatin unë dhe kolegë të tjerë), studimet jashtë vendit për një semestër dhe shumëçka tjetër, na hapën rrugë në ndërtimin e karrierës tonë profesionale. Suksese këto, pjesë e të cilave kam qenë dhe unë.”*



**Kujtim Aliu,**  
i diplomuar në programin e studimeve  
Inxhinieri me Informatikë:

*“Universiteti, që e përzgjedha të studioj, përmes bashkëpunimeve të shumta me kompani të ndryshme, më mundësoi që përmes punës praktike të kuptoj më mirë edhe aspektin teorik të programit të studimeve dhe të fitoj shkathtësitë e duhura, të cilat më ndihmuan të punësohem në një kompani në fushën e informatikës. Besoj se së shpejti do të vazhdoj me studimet Master, në po të njëjtin institucion.”*



**Arlind Ramadani,**  
i diplomuar në programin e studimeve  
Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve:

*“Gjithmonë më ka tërhequr vizatimi dhe dizajni, gjë që më bëri që unë të studioj në UShAF. Në sajë të Universitetit, që përveç mësimin teorik më ofroi edhe mësimin praktik, i cili më ndihmoi shumë që unë të zhvillohem në profesionin tim, tanimë kam hyrë në botën e dizajnit dhe besoj se do të kem një të ardhme të ndritur.”*



**Leona Jahiri**  
e diplomuar në programin e studimeve  
Menaxhment i Turizmit dhe Hotelierisë:

*“Turizmi dhe Hotelieria ishin ëndërr e imja qysh në fëmijëri, ëndërr kjo që, falë bashkëpunimit të Universitetit me industrinë brenda dhe jashtë Kosovës, e realizova menjëherë pasi fillova me studime në UShAF. Përvoja që fitova, përmes punës praktike në ndërmarrje të ndryshme vendore, po edhe në ato ndërkombëtare më dha mundësi të shumta punësimi, jo vetëm pas përfundimit të studimeve, po edhe gjatë studimeve.”*



**Maura Sweeney, Ambasadore e lumturisë në UNESCO:**

*“Jam shumë e nderuar që më është dhënë mundësia të ligjëroj në UShAF, rreth avancimit profesional, dhe të ndaj përvojën time si ambasadore e lumturisë.”*



**Prof. Asoc. Dr. Hamza Çiner Gazi, Profesor në Universitetin e Ankaras, Turqi:**

*“Jam shumë i kënaqur me cilësinë e studentëve të UShAF-it. Të jem i sinqertë, nuk kam pritur kaq shumë potencial dhe kaq shumë profesionalizëm (në dizajn) tek studentët. Jam me të vërtetë shumë i lumtur.”*



**Driton Emini, zëvendës president i Radio Networks T-Mobile Austria:**

*“Vizitat e shpeshta në UShAF, dhe ndarja e përvojës sime, në fushën e menaxhimit dhe teknologjisë, me stafin akademik dhe studentët e mrekullueshëm, kanë rëndësi të madhe për mua. Është sikur kthim në vendlindje, dhe kjo është më e pakta që mund të bëj për studentët e vendlindjes sime. Ndhem mirënjohës ndaj menaxhmentit të UShAF, që më dha mundësi të jem pjesë e këtij stafi shumë motivues.”*



**Prof. Adj. Prof. PD Dr. Alexander Petutschnigg  
Profesor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Salzburg, Austri  
Docent në Universitetin e Burimeve Natyrore (BOKU) Vjenë, Austri  
Profesor në Universitetin e Tennessee, Shtete të Bashkuara të Amerikës:**

*“Our collaboration with the University of Applied Sciences Ferizaj has been lasting for more than a decade now, and the tasks we solve together are of increasing importance. The success of this collaboration is the result of respect and willingness to help each other and the openness on both sides to learn from each other. I am thankful to Rector Bajraktari and his team for the inspiration, motivation and tasks we have shared and I look forward to tackling new challenges and doing projects also in the future. It is a pleasure and honor for me to be part of this success story.”*

*“Bashkëpunimi ynë me Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka filluar që më shumë se një dekadë dhe detyrat që zgjidhim bashkërisht kanë rëndësi të madhe. Rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm është respekti i ndërsjellë, gatishmëria për të ndihmuar njëri-tjetrin, si dhe sinqeriteti i dyanshëm për të mësuar nga njëri-tjetri. I jam mirënjohës Rektorit Bajraktari dhe ekipit të tij për frymëzimin, motivimin dhe detyrat që kemi ndarë. Mezi pres të ballafaqohemi me sfida të reja e të realizojmë projekte edhe në të ardhmen. Është kënaqësi dhe nder për mua të jem pjesë e kësaj historie të suksessit.”*



**Prof. PhD Mag. Michael Ebner,  
Profesor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Salzburg, Austri:**

*“Only through collaboration we will be able to tackle the challenges of the future. Collaboration in an interdisciplinary team and in an international context will be the motivation for our future cooperation. It will also be a necessity if we really want to achieve good results. At our partner institution in Ferizaj we have seen an exciting development in the field of teaching and research in the last years. In the years to come, this is the basement for the development and innovation in the area of Ferizaj and the whole Kosovo. Now it is time to think big and show the world what is possible.”*

*“Vetëm përmes bashkëpunimit do të mund të trajtojmë sfidat e së ardhmes. Bashkëpunimi në një ekip interdisciplinar dhe në kontekst ndërkombëtar, do të jetë motivimi kryesor për bashkëpunim në të ardhmen. Do të jetë poashtu i nevojshëm, normalisht nëse dëshirojmë të arrijmë rezultate të mira. Në institucionin tonë partner në Ferizaj, viteve të fundit, kemi vërejtur një zhvillim emocionues në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në vitet në vijim, ky është themeli për zhvillim e inovacion në rajonin e Ferizajt dhe në mbarë Kosovën. Është koha të kemi synime të mëdha dhe t'i tregojmë botës se çfarë është e mundur”.*



## SI TË BËHESH STUDENT NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Numri i studentëve që pranohen çdo vit mund të ndryshojë varësisht nga kushtet që parashtrihen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Bazuar në kushtet e parashtruara, Senati i Universitetit përcakton numrin e vendeve për studime Bachelor dhe Master, për secilën njësi akademike. Universiteti shpall konkurs për pranim të studentëve të rinj. Çdo kandidat që e kalon provimin e maturës shtetërore gëzon të drejtën për të aplikuar për studime në UShAF.

### PERIUDHA E APLIKIMIT

Kandidatët e interesuar për aplikim për studime Bachelor në Universitetin tonë, kanë 5 ditë kohë të bëjnë dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar. Pas përfundimit të afatit të aplikimit kandidatët, të cilët nuk posedojnë dëshmi se i janë nënshtruar testit të maturës, i nënshtrohen provimit pranues në datën, orën dhe vendin, që janë të përcaktuara në konkurs dhe të cilat mund t'i gjeni edhe në faqen e internetit të Universitetit ([www.ushaf.net](http://www.ushaf.net)). Shpallja e rezultateve të provimit pranues bëhet në fakultetet përkatëse, si dhe në faqen e

internetit të Universitetit. Nëse nuk plotësohet numri i studentëve në afatin e parë të konkurist, Universiteti ofron afat plotësues.

Kandidatët që janë të interesuar të aplikojnë për studime Master në Universitetin tonë kanë 9 ditë kohë të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 2-4 ditëve bëhet shpallja e rezultateve, të cilat mund t'i gjeni në fakultetet përkatëse si dhe në faqen e internetit të Universitetit [www.ushaf.net](http://www.ushaf.net).

### KUSHTET E APLIKIMIT

Të drejtë aplikimi në Universitet, në studimet Bachelor, kanë të gjithë kandidatët, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë, në njërin prej shkollave publike apo shkollave private, të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Në Universitet mund të aplikojnë edhe kandidatët nga shtetet e tjera, në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova. Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të dokumentohet në bazë të nostrifikimit nga organet kompetente. Vendimi për njohjen dhe barasvlerën e diplomës merret në MASHT.

Në studimet postdiplomike - Master në UShAF, mund të aplikojnë kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore, para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e Akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi për pranim do të kenë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet themelore - Bachelor në UShAF.

Të drejtë pranimi në UShAF kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Kandidatët, të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UShAF, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u regjistruar nga programi aktual i studimeve.

### PRANIMI NË USHAF


#### STUDIME BACHELOR

Për pranimin e kandidatëve në studime Bachelor, të gjitha fakultetet në kuadër të Universitetit, organizojnë mbajtjen e provimeve pranuese në lëndët mësimore, të cilat caktohen nga vet fakultetet.

Sa i përket kandidatëve që kanë diplomë të shkollës së mesme, por nuk i janë nënshtruar provimit të maturës (d.m.th. ata të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme para se të fillonte të aplikohet testi i maturës), numri maksimal i pikëve është 100, të cilat janë të ndara në 30 pikë për suksesin në shkollën e mesme, ndërsa 70 pikë për suksesin në provim pranues.

Për kandidatët që kanë diplomë të shkollës së mesme, por kanë kaluar me sukses provimin e maturës, numri maksimal i pikëve është 100, ku 30 pikë janë të ndara për suksesin në shkollën e mesme, 30 pikë janë të ndara për testin e maturës, ndërsa 40 pikë janë të ndara për pikët nga lëndët prioritare (3 lëndë).

Të drejtën e pranimit e sigurojnë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri



i pikëve të parapara për provim pranues. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.

#### STUDIME MASTER

Përzgjedhja e kandidatëve për studime Master përcaktohet sipas kriterëve, respektivisht pikëve, numri maksimal i të cilave është 100, prej të cilave 50 pikë janë të ndara për suksesin në studime themelore, ndërsa 50 të tjera për lëndët prioritare (5 lëndë).

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë

me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare.

Nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta, atëherë do të merret parasysh suksesi i studimeve themelore Bachelor. Nëse edhe suksesi është i njëjtë, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit, në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.

## TRANSFERI

Transferi nënkupton mundësinë e ndërrimit të programit të studimeve brenda Universitetit, por edhe kalimin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Gjatë ndërrimit të programit të studimit, studentit i lejohe të fillojë programin e ri të studimit, nëse së paku 50% e provimeve, të programit paraprak të studimeve, i ka dhënë me sukses dhe pranohen në programin e ri të studimit. Studenti lejohe të regjistrohet në programin e ri të studimit më së paku në vitin e dytë të studimeve dhe atë në fillim

të vitit akademik vijues. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti duhet të regjistrohet sërish në vitin e parë të studimeve në programin e ri.

Kjo sa i përket ndërrimit të programit të studimit brenda UShAF, ndërsa kalimi nga një universitet tjetër në Universitetin tonë, pos kushteve të mësipërme, kërkon edhe dëshmi rreth akreditimit të programit paraprak të studimit.

Transferi (pranimi) i notave dhe kredive (ECTS) bëhet nga Komisioni i Studimeve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në rregulloret e studimeve Bachelor dhe Master, përderisa vendimi merret nga Këshilli Mësimor/ Shkencor.

## ÇËSHTJET FINANCIARE

Si në studimet Bachelor poashtu edhe në ato Master, studentët janë të liruar nga pagesa për regjistrim të semestrit.

Çdo vit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ofron bursa për studentët e dalluar.



## MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA

Lëndë të strukturuar qartë, laboratore moderne dhe pajisje që përshtaten me mësimdhënie individuale, po edhe në grupe, ofrojnë kushte jashtëzakonisht të mira të mësimnxënies.

Gjatë përqendrimit në metoda praktike të mësimdhënies, studentët, gjatë studimeve, fitojnë edhe përvojë praktike. Kjo përvetësohet edhe më mirë përmes punës praktike, e cila është pjesë e integruar e programeve studimore.

Lidhja e ngushtë me industrinë dhe ndërmarrjet siguron mësimdhënie dhe mësimnxënie moderne të orientuar kah praktika. Kjo do të thotë se qasja e mësimdhënies në Universitetin tonë është e orientuar drejt aplikimit dhe produktit. Si rezultat i kësaj, të diplomuarit janë të përgatitur mirë për tregun e punës.

## NIVELET AKADEMIKE DHE LËNDËT

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ofron programe të studimeve në nivelin Bachelor dhe Master. Secili program i studimeve përpëhet nga lëndë, disa nga të cilat janë obligative e disa të tjera zgjedhore.

Studimet Bachelor, të ndara në gjashtë semestra, zgjasin 3 vite, me ç' rast, pas përfundimit të tyre, studentit grumbullon 180 kredi (ECTS), dhe merr diplomën për studimet përkatëse.

Studimet Master, të ndara në katër semestra, zgjasin 2 vite, pas përfundimit të të cilave studentit grumbullon 120 kredi (ECTS).



## KREDITË (ECTS)

Kreditë, apo Sistemi Evropian i Transferit dhe Akumulimit të Kredive (ndryshe ECTS – European Credit Transfer and Accumulation System), janë një mjet i Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, i cili bën studimet dhe lëndët të jenë më transparente.

Është mjet qëndror në Procesin e Bolonjës, i cili ka për qëllim që sistemin kombëtar të arsimit ta bëjë më të krahasueshëm ndërkombëtarisht. Që do të thotë se janë një sistem i standardizuar, i krijuar për të lehtësuar krahasimin e arritjes së studimeve dhe performancës së studentëve të arsimit të lartë në gjithë Bashkimin Evropian dhe në vendet tjera bashkëpunuese.

Ngarkesa e studentit sipas kredive (ECTS) bazohet në kohën që nevojitet për të kompletuar aktivitetet të ndryshme në kuadër të një lënde, siç janë: pjesëmarrja në ligjëratat e ushtrime, puna praktike, si dhe ajo në terren, projektet dhe prezantimet e ndryshme, etj.

## LIGJËRATAT

Ligjëratat janë të organizuara ashtu që studentëve t'u ofrojnë pikënisje të mirë rreth fushave të caktuara të njohurive, të cilat nxisin të mësuarit aktiv, të mësuarit multidisiplinar dhe zhvillim adekuat të shkathtësive të të menduarit kritik, ku përfshihen analiza, vlerësimi, aplikimi dhe realizimi. Shpesh ofrohen ligjëratat edhe nga përfaqësues të bizneseve, po edhe nga ligjërues ndërkombëtarë.

## TUTORËT

Secili mësimdhënës i rregullt në UShAF ka edhe rolin e tutorit për një numër të caktuar të studentëve. Tutorët janë përgjegjës për përcjelljen e zhvillimit të studentëve, si dhe t'u ndihmojnë atyre në aspekte të ndryshme, e sidomos t'i asistojnë dhe inkurajojnë studentët gjatë procesit të të mësuarit.



## ANGAZHIMI I STUDENTËVE

Që studentët të përfundojnë me sukses studimet, duhet që një pjesë të mirë të kohës ta kalojnë në aktivitetet, që u caktohen nga mësimdhënësit. Duke qenë se ligjëratat kanë qasje moderne, pra me studentin në qendër, angazhimi i tyre është pjesë e rëndësishme jo vetëm e realizimit të punës praktike, po edhe e pjesës teorike të planprogrameve. Angazhimi i tyre nënkupton përfshirjen në të lexuar, hulumtim, të shkruar si dhe në diskutime të ndryshme.

## VLERËSIMI I STUDENTËVE

Në të gjitha lëndët vlerësimi i studentëve bëhet gjatë gjithë kohës. Vlerësimet janë të formave të ndryshme, si për shembull përmes angazhimit në klasë, prezantimeve, eseve, dizajnit të produkteve të ndryshme, krijimit të produkteve, pjesëmarrjes në ekspozita, punës praktike, po edhe provimeve në fund të semestrit.

## FAKULTETI I MENAXHMENTIT

Në kuadër të këtij fakulteti ofrohet programi Menaxhim i Biznesit dhe Ndërmarrësi në ciklin e parë, pra në Bachelor si dhe në ciklin e dytë, pra në Master ofrohet programi i studimeve në Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacioni. Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar me kredi, të cilat janë në përputhje me sistemin evropian të kredive.

Fakulteti i Menaxhmentit u siguron studentëve staf akademik të kualifikuar, me infrastrukturë të nevojshme, përfshirë laboratore dhe pajisje moderne. Aspekti praktik i programeve fuqizohet edhe më shumë përmes punës në laboratore dhe hulumtimit, në bashkëpunim me kompanitë dhe institucionet vendore e ndërkombëtare.

Ky program u ofron studenteve njohuri dhe shkathtësi adekuate për fushën e profesionit të tyre, si dhe një orientim ndërkombëtar. U mundëson të zhvillojnë dhe përvetësojnë kompetenca menaxheriale, financiare, inxhinierike, të ndërmarrësisë dhe inovacionit, si dhe mundësi të mira për një karrierë fitimprurëse.

### Mendime të studentëve rreth përzgjedhjes së programit të studimeve në UShAF



**Yllka Jaha**, studente e vitit të tretë në programin Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia:

*“Duke parë mundësitë e shumta që u janë dhënë të diplomuarve, si dhe atyre që po na ofrohen neve, përmes kontakteve me kompani të ndryshme gjatë realizimit të punës praktike, përmes studimeve semestrale jashtë vendit, përmes angazhimit në laboratorët moderne të Universitetit, mund të them se UShAF është vendi i duhur për të studiuar.”*



## BACHELOR

Programi trevjeçar “Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia” në Fakultetin e Menaxhmentit ofron një kombinim të avancuar të njohurive teorike dhe praktike në fushën e biznesit dhe ndërmarrësisë. Ky program synon të pajisë studentët me aftësi në inovacion, planifikim strategjik të aktiviteteve biznesore, komunikim në biznes dhe menaxhim të përgjithshëm.

Përmes një qasjeje bashkëkohore në mësim, që përfshinë punën individuale dhe atë në grup, studentët mësojnë të analizojnë dhe të zgjidhin sfida reale të biznesit duke përdorur metoda të avancuara të hulumtimit. Gjithashtu, ata zhvillojnë projekte konkrete në fushën e menaxhimit, duke fituar përvojë praktike në planifikimin, inicimin dhe realizimin e iniciativave të ndryshme biznesore.

## QËLLIMI

Zhvillimet ekonomike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kanë krijuar një kërkesë të theksuar për të studiuar në fushën e Menaxhimit të Biznesit dhe Ndërmarrësisë. Ky program u ofron studentëve njohuri me perspektivë globale, duke i pajisur ata me kompetenca të avancuara në menaxhim dhe me një mendësi ndërmarrëse inovative.

Qëllimi i programit është të përgatisë profesionistë të kualifikuar, të cilët do të kontribuojnë në strukturimin, organizimin dhe zhvillimin e bizneseve, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Përmes këtij programi, studentët do të kenë mundësinë të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e ekosistemit ekonomik, duke nxitur rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të biznesit.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët të kenë sukses në një mjedis shumë konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti ofron ndërlidhje të duhur të mësimit teorik dhe atij praktik për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive specifike, përmes të cilave studentët do të jenë në gjendje:

- të zhvillojnë aftësi të avancuara të komunikimit, si në formë të shkruar ashtu edhe verbale,

duke përdorur metodologji dhe teknologji bashkëkohore;

- të bashkëpunojnë në mënyrë efektive në mjedise grupore, duke integruar përvoja, aftësi dhe kompetenca të ndryshme individuale për arritjen e objektivave të përbashkëta;
- të demonstrojnë njohuri themelore në analizat numerike dhe financiare për një planifikim të suksesshëm biznesor;
- të njohin menaxhimin e burimeve, aspektet etike, mjedisore dhe legjislativë gjatë procesit të vendimmarrjes në biznes;
- të përdorin mjetet e duhura strategjike në procesin e vendimmarrjes, për të zgjidhur probleme komplekse në mënyrë analitike, kritike dhe inovative;
- të demonstrojnë aftësi dhe njohuri të menaxhimit të përgjithshëm dhe të menaxhimit të projekteve (MS Project Management,) si dhe aplikimin e tyre në situata praktike të biznesit;
- të realizojnë përdorimin e metodave tradicionale dhe dixhitale të marketingut dhe shitjes;
- të identifikojnë hallkat e zinxhirit furnizues dhe proceset e prodhimit, si dhe implikimin e tyre në procesin e zhvillimit të produktit;
- të kuptojnë konceptet themelore të ndërmarrësisë, ndërmarrësinë e qëndrueshme si dhe inovacionet dhe trendet e ardhshme zhvillimore;
- të njohin problemet me të cilat përballen ekonomia lokale dhe globale, si dhe aftësitë për të identifikuar dhe shfrytëzuar mundësitë e reja të biznesit për ndërmarrësit;
- të kuptojnë se çfarë nevojitet për identifikimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mundësive të reja (produkteve dhe shërbimeve).

### Mundësi punësimi në të ardhmen

Pas përfundimit të studimeve, një i diplomuar do të mund të punonte si:

- zyrtar në agjenci të ndryshme qeveritare në monitorimin e zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit,
- zyrtar në kuadër të ministrive të ndryshme,
- zyrtar në ndërmarrje publike,
- menaxher i sistemeve në organizatë,
- konsulent i operacioneve,

# PLANPROGRAMI ME LËNDËT OBLIGATIVE DHE LËNDËT ZGJEDHORE

- menaxher në organizatë,
- zhvillues/menaxher produkti,
- menaxher i përgjithshëm në organizata të

- ndryshme,
- i vetëpunësuar dhe sipërmarrës,
- menaxher i projektit.

### Viti I

Semestri I				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Informatika në biznes	3	6
2	O	Matematika për Biznes	3	6
3	O	Mjedi Biznisor	3	6
4	O	Hyrja në Ekonomi	3	6
5	O	Shkathtësi akademike dhe komunikim në Biznes	3	6

Semestri II				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Menaxhmenti	3	6
2	O	Vendimmarrja në Biznes	3	6
3	O	Menaxhimi i Inovacioneve	3	6
4	O	Statistika Biznesore	3	6
5	O	Gjuhë Angleze I	2	3
6	O	Gjuhë Gjermane I	2	3

### Viti II

Semestri III				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Analiza e Tregut dhe Sjellja e Konsumatore	3	5
2	O	Menaxhimi i burimeve njerëzore	3	5
3	O	Marketingu	3	5
4	O	Menaxhimi i operacioneve	3	5
5	O	Gjuhë angleze II	2	3
6	O	Gjuhë Gjermane II	2	3
7	Z	Menaxhimi i dijes	3	4
8	Z	Ndërmarrësia sociale	3	4

Semestri IV				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Ndërmarrësia	3	5
2	O	Kontabiliteti	3	5
3	O	E drejta biznesore dhe etika	3	5
4	O	Sjella Organizative	3	5
5	O	Gjuhë angleze III	2	3
6	O	Gjuhë Gjermane III	2	3
7	Z	Menaxhimi i Sistemit Informativ në Ndërmarrje	3	4
8	Z	Qëndrueshmëria e Ambientit dhe Ndërmarrësia	3	4

### Viti III

Semestri V				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Menaxhimi i marrdhënjëve me klientë	3	5
2	O	Shitja dhe Menaxhimi i shitjes	3	5
3	O	Menaxhimi i ndryshimeve	3	5
4	O	Produkti dhe vendosja e çmimeve	3	6
5	O	Menaxhimi Strategjik	3	5
6	Z	Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në ndërmarrje	3	4
7	Z	Planifikimi Biznisor	3	4

Semestri VI				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Menaxhimi i projekteve	3	5
2	O	Menaxhimi i Financave	3	6
3	O	Intership (Mësim praktik në ndërmarrje)	4	6
4	O	Lidershipi	3	5
5	O	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	3	4
6	Z	Logjistika dhe Transporti	3	4
7	Z	Mediat sociale dhe ekonomia dixhitale	3	4

**MASTER**

Programi i studimeve Master në “Menaxhimin e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit”, që ofrohet në kuadër të Fakultetit të Menaxhimentit, është i dizajnuar për të pajisur studentët me njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fushën e ndërmarrësisë dhe inovacionit. Ky program synon të zhvillojë një mendësi të orientuar drejt ndërmarrësisë dhe inovacionit, duke integruar metoda të avancuara të dizajnit të mendimit ndërmarrës, mendimit kreativ dhe inovativ, teknikave të negociatave, si dhe qasjeve bashkëkohore në ekonominë qarkore dhe digjitale. Gjithashtu, programi u mundëson studentëve të përvetësojnë aftësi në menaxhimin financiar të avancuar, të aplikojnë në mënyrë etike dhe të saktë legjislacionin ekonomik dhe të zhvillojnë kompetenca kyçe që i bëjnë ata konkurrues në tregun e punës. Ky program ofron një metodologji moderne të të mësuarit, e cila përfshin qasje interaktive, punë individuale dhe bashkëpunim në grupe për të adresuar dhe zgjidhur sfidat teorike dhe praktike të ndërmarrësisë dhe inovacionit. Studentët do të angazhohen në kërkime të avancuara, duke planifikuar, iniciuar dhe realizuar projekte konkrete në përputhje me kurrikulën e programit. Nëpërmjet këtij programi, studentët do të zhvillojnë aftësi kritike për të menaxhuar dhe drejtuar organizata inovative, për të krijuar mundësi të reja biznesi dhe për të implementuar strategji efikase në një mjedis ekonomik në ndryshim të vazhdueshëm.

**QËLLIMI**

Programi Master në “Menaxhimin e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit” synon të zhvillojë aftësi të avancuara dhe strategji efektive për formimin e profesionistëve me një mendësi inovative dhe ndërmarrëse. Ky program është i orientuar drejt ndërtimit të kompetencave në menaxhim, krijim dhe zbatim të inovacioneve ndërmarrëse, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme dhe konkurruese të bizneseve në një ekonomi tregu në zhvillim. Në kontekstin e dinamikave të vazhdueshme ekonomike, si në nivel kombëtar ashtu edhe

ndërkombëtar, studimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit është bërë një domosdoshmëri. Ky program u mundëson studentëve të përfitojnë njohuri të avancuara me aplikueshmëri globale, duke i përgatitur ata për të operuar në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe për të qenë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe inovativ.

**OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

Që studentët të aftësohen në fusha të menaxhimit të biznesit, që janë të domosdoshme për suksesin e kompanive brenda sektorit të prodhimit dhe shërbimeve (kryesisht menaxhimi i operacioneve, marketingut dhe menaxhimit financiar), programi ofron përvetësimin e shkathtësive teorike e praktike, përmes të cilave studentët do të jenë në gjendje:

- të zhvillojë njohuri të avancuara për të krijuar dhe mbështetur modelet në ndërmarrësi inovative;
- të ndërtojë aftësi për ide të reja ndërmarrëse të qëndrueshme në një ambient dinamik dhe të pa-parashikuara të tregut;
- të hartojë strategji krijuese për ndjekjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mundësive të reja;
- të përpilojë plane të biznesit, duke përfshirë kapitalin financiar, legjislacionin, hulumtimin e tregut, dhe aspektet teknologjike;
- të prezantojë dhe komunikojë idetë/modelet e biznesit duke përdorur pajisjet teknologjike dhe programet softuerike,
- të demonstrojë shkathtësi menaxheriale për zgjidhjen e problemeve ndërlidhur me ndërmarrjen, ekonominë dixhitale dhe menaxhimin e inovacionit;
- të planifikojë në mënyrë strategjike burimet njerëzore, të menaxhojë zingjirin furnizues duke vlerësuar riskun dhe rëndësinë e negociimit në ndërmarrje;
- të zotërojë njohuri dhe kompetenca për konceptet që mbështesin inovacionin ndërmarrës brenda organizatës;
- të implementojë hapat e nevojshëm për shndërrimin e idesë në një Start-Up; dhe

- të aplikojë metoda të ndryshme të kërkimit shkencor që përdoren në ndërmarrësi, inovacion dhe teknologji të re.

- menaxher i projekteve inovative,
- menaxher ndërmarrjeje,
- këshilltar legjislativ për ndërmarrësi dhe inovacion,
- hulumtues dhe zhvillues i biznesit,
- konsulent i dizajnit të biznesit dhe inovacionit,
- konsulent i ndërmarrjes,
- menaxher i riskut në ndërmarrje,
- i punësuar në institucione publike, etj,

**MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN**

Pas përfundimit të studimeve, një i diplomuar do të mund të punonte si:

- themelues i ndërmarrjes dhe CEO,

Viti I				
Semestri I				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Inovacioni dhe ndërmarrësia	3	6
2	O	Ekonomia ne ndërmarrësi dhe inovacion	3	6
3	O	Legjislacioni dhe biznesi	3	6
4	O	Kapitali në ndërmarrësi dhe menaxhimi financiar	3	6
5	O	Ndërmarrësia dhe rritja e bizneseve inovative	3	6
<b>Gjithsejt ECTS</b>				<b>30</b>
Semestri II				
1	O	Biznesi dixhital	3	5
2	O	Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit	3	6
3	O	Faktori njerëzor në inovacion	3	5
4	O	Ekonomia cirkulare në ndërmarrësi	3	6
5	Z	Modelet e biznesit për ekonominë dixhitale	3	4
6	Z	Menaxhimi strategjik inovativ	3	4
7	Z	Menaxhimi i Inovacionit dhe Teknologjisë	3	4
<b>Gjithsejt ECTS</b>				<b>30</b>
Viti II				
Semestri III				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Metodat kërkimore	3	5
2	O	Menaxhimi i projekteve inovative	3	6
3	O	Dizajnimi i të menduarit dhe inovacioni	3	5
4	O	Vlerësimi i riskut dhe analiza e vendimeve	3	6
5	Z	Negocimi dhe komunikimi në biznes	3	4
6	Z	Etika në biznes dhe qëndrueshmëria e bizneseve	3	4
7	Z	Zhvillimi i inovacionit personal	3	4
<b>Gjithsejt ECTS</b>				<b>30</b>
Semestri IV				
1	O	Tema e Master		30
<b>Gjithsejt ECTS</b>				<b>30</b>



## FAKUKTETI I INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS

Në kuadër të këtij fakulteti ofrohet programi i studimeve Inxhinieri Industriale me Informatikë, në ciklin e parë, pra në bachelor, programi i studimeve në Informatikë të Aplikuar, në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe programi i studimeve në Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit, në ciklin e dytë, pra në master. Programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredi, të cilat janë në përputhje me sistemin evropian të kredive. Këto programe u ofrojnë studentëve përvetësimin e shkathhtësive adekuate për fushën e tyre të profesionit që do të ushtrorjnë në të ardhmen. Kjo mundësohet përmes ambienteve moderne të punës, pra laboratoreve dhe pajisjeve moderne, si dhe përmes bashkëpunimit me kompani e institucione kombëtare e ndërkombëtare.

Mendime të studentëve rreth përzgjedhjes së programit të studimeve në UShAF



**Donikë Guri**, studente e vitit të tretë në programin Inxhinieri Industriale me Informatikë:

*“Perspektiva e madhe për vende të punës në rajonin e Ferizajt, si dhe pozita gjeografike e Universitetit kanë bërë të jenë zgjedhje ideale për mua. Mundësitë e studimit semestral jashtë vendit, vizitat e shumta në kompani të ndryshme, pastaj puna praktike në to, po edhe në laboratorët e Universitetit, ofrojnë mundësi jashtëzakonisht të mëdha në avancimin tonë. Falë shumëllojshmërisë së lëndëve në këtë fakultet, ne tashmë jemi të aftë në fushën e inxhinierisë si dhe në fusha të tjera si: informatika, fizika e matematika.”*

## BACHELOR

Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë fokusohet në zhvillimin e kuadrove të reja në fushën e inxhinierisë industriale, dhe aplikimin e teknologjisë informative në proceset e përpunimit të metaleve dhe materialeve të ndryshme plastike, duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të teknologjisë informative, të cilat u përshtaten kërkesave të tregut të punës.

## QËLLIMI

Duke ditur se tregu i punës ka mungesë të profesionistëve në fushën e inxhinierisë industriale dhe aplikimit të teknologjisë informative në proceset e përpunimit të produkteve, Universiteti, përmes këtij programi, ka për qëllim të krijojë kuadro të kualifikuara vendase, të cilat në të ardhmen do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët në të ardhmen të kenë sukses në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon studentëve të:

- identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin problemet industriale me ide kreative dhe inovative;
- njohin llojet e materialeve (metalet, materialet artificiale dhe ato kompozite) si dhe teknologjitë e përpunimit të tyre;
- zhvillojnë dhe përsosin organizimin, komunikimin, kontrollin dhe aftësitë e tjera profesionale multidisiplinare në ndërmarrje industriale;
- iniciojnë, planifikojnë dhe menaxhojnë projekte të ndryshme profesionale në fushën e inxhinierisë industriale;
- zhvillojnë aftësi teknike të dizajnit dhe

- duke përdorur softuerët aplikativ (sikurse janë AutoCAD, Inventor, etj) në dizajnin, analizën dhe simulimin e funksionimit të produktit (gjenerimit të shpejt të prototipit, vizualizimi përmes teknologjisë VR, etj);
- aplikojnë njohuri të koncepteve, teorive dhe disiplinave në inxhinieri industriale, të përkrahura nga teknologjia informative;
- zbatojnë procese gjithëpërfshirëse përmes të cilave mund të integrojnë modelimin e sistemeve mekanike me sistemet softuerike dhe elektrike;
- shfrytëzojnë dhe aplikojnë teknika të ndryshme inxhinierike për të zgjedhur probleme reale në procese të zhvillimit/dizajnit/përmirësimit të produkteve/sistemeve duke përdorur pajisje dhe sisteme moderne (softverët, 3d Scanner dhe printer, etj);
- kuptojnë kompleksitetin e procesit të operacioneve të prodhimit dhe ndikimit të tij në dizajnin e produktit apo procesit, dhe anasjelltas, duke optimizuar koston e prodhimit; dhe
- kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së ambientit, dhe ndikimin e tij në dizajnin e produkteve dhe proceseve të prodhimit.

## MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, një i diplomuar do të mund të punonte si:

- inxhinier i prodhimit dhe projektimit të sistemeve industriale,
- zhvillues produkti,
- zhvillues dhe dizajner i procesit,
- udhëheqës në industri të prodhimit, dhe
- vetëpunësuar dhe sipërmarrës.

### Viti I

Semestri I				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Algjebra me gjeometri analitike	3	5
2	O	Kimi	3	5
3	O	Materialet inxhinierike I	3	5
4	O	Shkathësi komunikuese	3	5
5	O	Grafika Inxhinierike	3	5
6	O	Softuerët Aplikativ	3	5

Semestri II				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Calculus	3	5
2	O	Fizikë	3	5
3	O	Mekanika I	3	5
4	O	Materialet Inxhinierike II	3	5
5	O	Ndërmarrje dhe inovacion	3	4
6	O	Gjuhe Angleze I	2	3
7	O	Gjuhe Gjermane I	2	3

### Viti II

Semestri III				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Matematike Inxhinierike	3	5
2	O	Programimi	3	5
3	O	CAD I	3	5
4	O	Mekanike II	3	5
5	O	Proceset e prodhimit	3	5
6	O	Gjuha Angleze II	2	3
7	O	Gjuha Gjermane II	2	3

Semestri IV				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Bazat e elektroteknikes me elektronike	3	5
2	O	CAD II	3	5
3	O	Detalet e makinave	3	5
4	O	Përpunimi i materialeve I	3	5
5	O	Programimi i orientuar në objekte	3	4
6	O	Gjuha Angleze III	2	3
7	O	Gjuha Gjermane III	2	3

### Viti III

Semestri V				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	Riciklimi i materialeve	3	4
2	O	Menaxhimi i projekteve inxhinierike	3	4
3	O	Metodat jokonvencionale të përpunimit	3	5
4	O	Saldimi	3	5
5	O	Energjia në dizajnin inxhinierik	3	4
6	O	Projektimi i proceseve teknologjike	3	4
7	Z	Hidraulike dhe Termodinamike	3	4
8	Z	Mekatronika	3	4
9	Z	Matja dhe kontrolli	3	4

Semestri VI				
Nr.	O/Z	Lëndët	Orë/javë	ECTS
1	O	CAD/CAM	3	4
2	O	Dizajni dhe zhvillimi i produkteve	3	4
3	O	Praktike (Internship)	3	5
4	O	Rregullimi automatik/kontrolli	3	5
5	O	Inxhineria kthyesë dhe modeli 3D	3	4
6	O	Përpunimi i materialeve II	3	4
7	Z	Menaxhimi i kostos	3	4
8	Z	Sistemet hidraulike dhe pneumatike	3	4
9	Z	Ngrohja dhe ventilimi i objekteve	3	4

## BACHELOR

Gjatë takimeve të shumta me komunitetin e biznesit, shpesh është diskutuar kërkesa e të kualifikuarve në fushën e informatikës së aplikuar. Prandaj, mund të themi se programi Informatikë e Aplikuar, si një fushë relativisht e re e studimit në Kosovë, u dedikohet të rinjve që duan të jenë më praktik dhe që kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori. Programi mbulon një gamë të gjërë temash që ofrojnë një kombinim të specializuar të njohurive në shkencat kompjuterike, në programim, në administrim të rrjeteve kompjuterike, në biznes dhe menaxhim. Studentët fitojnë një pasqyrë të detajuar të teknologjive më të fundit të informacionit dhe komunikimit.

## QËLLIMI

Programi ka për qëllim të ofrojë lëndë me përmbajtje moderne dhe fleksibile, si dhe vendosje praktike në industri, të cilat do të ndjekin me lehtësi kërkesat e ekonomisë vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të tregut të punës në nivel lokal, rajonal dhe global.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët të kenë sukses në të ardhmen, në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon studentëve të:

- analizojnë kërkesat e TI-së duke marrë parasysh nevojat e konsumatorëve dhe të biznesit, përshkruaj ato në nivel abstrakt dhe arsyetojë formën e përcaktuar të zbatimit të tyre;
- analizojnë, dizajnojnë dhe zhvillojnë zgjedhje softuerike të orientuar nga objektet për probleme reale në fusha të ndryshme dhe t'i mirëmbajë ato;
- zbatojnë teknikat e testimit të softuerit, sigurimit të cilësisë dhe të demonstrojnë aftësi në menaxhim të ndryshimeve;
- konceptojnë dhe zbatojnë harduerin mbështetës për sistemet e informacionit si dhe

të dizajnojnë, konfigurojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë rrjeta kompjuterike duke aplikuar standarde të larta të sigurisë;

